

FORMULARI NUMËR 4
KONCEPT DOKUMENTI PËR KRYEPROKUROR

Mbiemri:	ÇERKINI
Emri:	BURIM

I. Analizën tuaj, si vijon:

Bazuar në kompetencat ligjore të parapara për pozitën që aplikoni, ju lutem të ofroni:

I. Analizën tuaj, si vijon:

1. Si e vlerësoni gjendjen aktuale në Prokurorinë e Shtetit?
2. Si e vlerësoni gjendjen aktuale në Prokurorinë që keni aplikuar?
3. Cilat janë mangësitë dhe sfidat kryesore të kësaj prokurorie?
4. A mendoni se strategjitet aktuale të sistemit adresojnë nevojat e Prokurorisë për të cilën aplikoni si Kryeprokuror?

1. Si e vlerësoni gjendjen aktuale në Prokurorinë e Shtetit?

1.1. Bazuar në kompetencat ligjore të parapara për pozitën që aplikoj (Kryeprokuror në Prokurorinë Themelore në Ferizaj), të përcaktuara në nenin 21, te Ligjit nr.08/L-167 për prokurorin e shtetit, gjendjen aktuale në Prokurorinë e Shtetit e vlerësoj si në vijim:

Prokuroria e Shtetit gjatë viteve të fundit ka shënuar rritje në aspektin e profesionalizmit dhe ka ngritur nivelin e performancës së punës së prokurorëve si në procedimin dhe përfaqësimin e rasteve në të gjitha Prokuroritë themelore dhe PSRK në raport me rastet e pranuara dhe rastet e trashëguara.

Ka një progres të dukshëm në ngritjen e kapaciteteve kadrorike të rritjes së numrit të prokurorëve ne raport me nevojat e secilës Prokurori e që ka ndikuar pozitivisht në zgjedhjen e rasteve dhe në luftën e kriminalitetit dhe dukurive negative në shoqëri. të viteve të fundit Prokuroria e Shtetit ka shënuar një progres të dukshëm në ngritjen e kapacitetit institucional si në kuadrin e duhur profesional ashtu edhe në infrastrukturë ligjore, e që kjo ka ndikuar pozitivisht edhe në luftë ndaj krimít dhe dukurive të tjera negative në shoqëri.

Prokuroria e shtetit ka arritur rezultate edhe ne fushën e sekuestrimeve, e që ishte njëra ndër objektivat kryesore përkundër se akoma mungojnë vendimet përfundimtare gjyqësore.

Konsideroj se strategjitet e detajuara për luftimin veprave penale karakteristike si në luftimin e krimit të organizuar dhe korruptionit, strategjia për viktimat e dhunës në familje, janë duke u zbatuar në masë të madhe nga ana e Prokurorëve te Shtetit e që është edhe qëllim kryesor i Prokurorit të Shtetit.

Sigurisht se në punën e prokurorit të shtetit ka vend ende për të punuar drejtë fuqizimit të institucionit të Prokurorit të Shtetit si një sistem i pavarur, llogaridhënës, me integritet, performancë dhe profesionalizëm më të madh duke u bazuar në sfidat që dalin gjatë punës së përditshme.

Një ndër sfidat në punën e prokurorit të shtetit është se nuk është arritur ende që të zgjogëloj mjaftueshëm regjistrimin e rasteve në regjistrin PPN dhe PPP nëpër prokuroritë themelore dhe PSRK, me qëllim të ngritjes së efikasitetit edhe më të madh në procedimin e rasteve, respektivisht arritjes së objektivave dhe normës vjetore nga ana prokurorëve.

Sfidë tjetër në punën e Prokurorit të Shtetit është edhe ndërtimi i praktikave unike për rastet e ngjashme, prandaj edhe pritet e prokurorëve janë që Kryeprokurori i shtetit të jep udhëzime më të shpeshta me shkrim me qëllim të zbatimit të ligjshmërisë dhe ngritjes së efikasitetit të prokurorive.

Ka vend për avancimin e metodave në vlerësimin e punës së prokurorëve ku duhet të ndërtohet në bazë të fakteve të grumbulluara përgjatë gjithë viti, si psh. vëzhgimi në seanca gjyqësore, diskutimi gjashtëmujor me prokurorë dhe vëzhgimi i pandërprerë i procedimit të rasteve të prokurorëve përmes sistemit elektronik SMIL;

2. Si e vlerësoni gjendjen aktuale në Prokurorinë që keni aplikuar?

2.1. Bazuar në kompetencat ligjore të parapara për pozitën që aplikoj, Kryeprokuror në Prokurorinë Themelore në Ferizaj, të përcaktuara në nenin 21, te Ligjit nr.08/L-167 për prokurorin e shtetit, gjendjen aktuale në PSRK e vlerësoj si në vijim:

Gjendja në Prokurorinë Themelore në Ferizaj është e mirë, ka një avancim sa i përket zgjidhjes së rasteve dhe transparencës dhe ndaj publikut , kjo me qëllim të ngritjes akoma më shumë të besueshmërisë së publikut në këtë prokurori.

Numri i prokurorëve dhe stafit mbështetës është i kënaqshëm ku me këtë numër të prokurorëve është duke u arritur me sukses përbushja e objektivave, zgjidhja e rasteve, përfaqësimi i rasteve në gjykata, përkundër asaj se numri i gjyqtarëve është i madh dhe gjykimeve të caktuara.

Për sa i takon gjendjes aktuale të kësaj prokurorie lidhur me ngarkesën me lëndë si dhe zgjidhjes së tyre gjendja është e mirë, kjo është arritur here pas here përmes angazhimit shtesë të Prokurorëve ashtu që mos të ketë mbingarkesë me lëndë.

3. Cilat janë mangësitë dhe sfidat kryesore të kësaj prokurorie?

Në Prokurorinë Themelore në Ferizaj, si edhe në çdo Prokurori tjetër janë identifikuar sfidat kryesore të punës së saj. Sfidë e identifikuar në këtë prokurori është numri i madh i lëndëve PPP (kallëzimeve penale me persona të panjohur) të trashëguara gjatë viteve, ku një numër i tyre ka mbetur ende pa përfunduar përfaktin se për një periudhë të gjatë kohore Policia e Kosovës edhe pas kërkesës sonë nuk kanë mundur të identifikojnë kryerësit e këtyre veprave penale, ku prej disa prej këtyre rasteve penale nuk ka parashkrim absolut dhe si të tilla ende mbeten lëndë të pakryera.

Sfidë tjetër gjatë viteve të fundit, por që konsiderohet gati e tejkaluar është funksionalizimi komplet i projektit SMIL në të gjitha komponentët e tij, kjo edhe përfaktin se kjo prokurori ka qenë pilot projekt ku është kërkuar angazhim maksimal i gjithë stafit dhe prokurorëve, ku shpesh herë janë paraqitur pengesa të natyrave të ndryshme por të cilat janë evituar në kohë të arsyeshme.

Theksoj se kjo sfidë do të përfundoj me sukses pasi që tani, duke qenë edhe anëtër i grupit punues i caktuar nga KPK, jemi duke i bërë edhe planet dhe objektivat e funksionalizimit në tërësi e që përfshin raportimin elektronik të punës së të gjitha prokurorive, duke përdor përpiluar raportet statistikore elektronike si edhe heqjen e regjistrave manual dhe kalimit në regjistrat elektronik.

Për sa i takon mangësive konsiderojë se në PTH Ferizaj, duhet të angazhohemi në avancimin në ngritjen e hetimit financiar, krimeve ekonomike dhe korruptionit, ngritjen e cilësisë së akteve akuzuese të mbështetura në prova, aplikimin më të madh të procedurave alternative, institutit të marrëveshjes përfaktive pranimin e fajësisë. Do të punohet ne prezantimin të suksesit dhe llogaridhënieve së prokurorëve përfaktive dështimet në procedimin e rasteve të ndjeshme, përmes transparencës me publikun.

4. A mendoni se strategjitet aktuale të sistemit adresojnë nevojat e Prokurorisë përf të cilën aplikoni si Kryeprokuror?

Lidhur me strategjitet aktuale të sistemit, konsideroj se se strategjitet aktuale i adresojnë nevojat e prokurorisë, mirëpo nevojitet monitorimi në zbatimin e objektivave dhe aktiviteteve të përcaktuara në këto strategji;

Për zbatimin plotë të strategjive të gjitha prokuroritë duhet të hartojnë planet e veprimit duke adresuar objektivat dhe përcaktuar prokurorët të cilët do të realizojnë ato aktivitete, nën monitorimin e vazhdueshëm të kryeprokurorit për të finalizuar ato objektiva;

Në pajtueshmëri me këto strategji të adresuara duhet të ndërmerren veprime konkrete ku koordinatorët e caktuar ne PTH Ferizaj , si koordinatori për trafikim me qenie njerëzore dhe dhunës në familje, për lëndët e korruptionit , do të kenë një rol kyç në adresimin e të gjitha sfidave dhe së bashku me ta duke bërë kontrollimin mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e këtyre lendeve, por që nuk duhet të mjaftohemi me këtë, do të angazhohemi në baza ditore për trajtimin e lëndëve me prioritet lartë dhe me profesionalizëm.

II. Vizioni juaj në përmirësimin e punës operative në Prokurorinë që keni aplikuar?

Ju lutem listoni/përmendni veprimet e juaj afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjate:

1. Cili është vizioni juaj për të përmirësuar punën operative gjatë mandatit tuaj?
 2. Cilat janë objektivat tua ja kryesore?
 3. Cilat janë vështirësitë që i prisni gjatë përbushjes së këtyre objektivave?
 4. Si do t'i tejkalonit ato?
-

1. Cili është vizioni juaj për të përmirësuar punën operative gjatë mandatit tuaj?

Vizioni im si Kryeprokuror do të jetë puna e vazhdueshme për arritjen e standardeve dhe vlerave më të larta të, profesionalizmit, illogaridhënisë dhe transparencës, ndershmërisë, integritetit përmes marrjes së vendimeve që sigurojnë pavarësinë e punës së prokurorit të shtetit , paanshmërinë dhe efikasitetin e prokurorisë si dhe bashkëpunimi institucional me faktorët relevant për sundimin e ligjit.

Do të angazhohemi dhe udhëhiqem për një sistem sa ma të pavarur dhe të pa anshëm që do të siguronte trajtim profesional të ndjekjes penale duke respektuar standarde më të larta të hetimit, që është vizion i prokurorisë dhe përfshihet po edhe në ndërmarrjen e veprime të mia afatgjatë.

Do të punojmë nga afër së bashku me prokurorët kompetent në trajtimin e veprave karakteristike ku kemi strategji kombëtare për luftimin e tyre, e posaçërisht veprat e natyrës korruptove, krimeve ekonomike, trafikimit me qenie njerëzore, trafikimi i lëndëve narkotike.

Ky është një përkufizim i përgjithshëm i aspekteve që një Kryeprokuror mund të konsiderojë për të përmirësuar punën operative. Konkretizimi i vizionit dhe qëllimeve të tij do të ndikohet nga rrethanat dhe kushtet aktuale të vendit dhe institucionit.

2. Cilat janë objektivat tuaja kryesore?

Puna ime si Kryeprokuror do të udhëhiqet duke u bazuar në parimin e kushtetutshmërisë dhe Ligjshmërisë, përmes së cilët parim do të garantohet që të gjithë qytetarët, pa marrë parasysh statusin e tyre në shoqëri apo në procedurë do të kenë qasje të barabarte në drejtësi duke siguruar që prokurori i shtetit do te veproj në mënyre profesionale, te pavarur, te paanshme dhe llogaridhënës, duke respektuar natyrën e secilit shume etnike dhe të drejtën e barazisë gjinore.

Ndër objektivat kryesore do te jenë:

- Profesionalizmi
- Pavarësia
- Llogaridhënia
- Transparency
- Disiplinimi, dhe
- Besimi i publikut

Profesionalizmi është ndër objektiva e mia kryesore. Kjo objektivë do të arrihet duke punuar në bashkëpunim me prokurorët në punë ekipore, stafin profesional si dhe me institucionet e tjera të sundimit të ligjit, për të arritur një profesionalizëm më të lartë në hartimin përpilimin e akteve akuzuese, hetimeve, përpilimin e mjeteve juridike dhe çështje tjera që mundësojnë arritjen e vlerave të larta profesionale.

Pavarësia në punën e prokurorit do të jetë objektivë tjetër e imja, ku prokurorët duhet të jenë në gjendje të kryejnë hetimet dhe ndjekjet penale në mënyrë të pavarur dhe në përputhje me ligjin pavarësisht çfarëdo nga ndikimi dhe menaxhimi i rasteve me profesionalizëm.

Llogaridhënia do të jetë objektivi tjetër i punës sime përmes së cilët parim do të udhëheqë-menaxhoj në përgjithësi në Prokurorinë Themelore në Ferizaj, do të kërkojë nga vartësit të veprojnë me kohë në procedimin e lëndëve penale, përfaqësim të mirëfilltë të akteve akuzuese në gjykatë, trajtim të barabartë të qytetarëve para ligjit dhe ngritje të cilësisë së punës dhe efikasitetit.

Disiplinimi nënkuption që unë si autoritet kompetent në trajtimin e çështjeve të ngritura nga qytetarët për sjelljen etike të prokurorëve do të veproj me kohë brenda afateve ligjore dhe bazuar në shkeljet eventuale do ti propozojë Këshillit Prokurorial të Kosovës masa adekuate disiplinore bazuar në shkeljet e identikuara.

Transparency përfshin po ashtu një objektiv tjetër të punës në Prokurorinë Themelore në Ferizaj e cila do te jetë e bazuar në parimin e transparencës gjithherë ku publiku do të ketë qasje në informatat në interes të tyre brenda kornizës ligjore qe i lejon.

Bashkëpunimi ndërinstolucionale dhe kolegiale do të jenë parim i punës sime si me institucionet që punojnë në sundimin e rendit dhe ligjit duke përfshirë gjykatat, policinë, doganën, Administratën Tatimore të Kosovës, duke krijuar mundësinë e koordinimit për një luftim më të suksesshëm të kriminalitetit dhe dukurive negative në shoqëri.

Besimi i publikut do të jetë një nga angazhimet e mia, arritja e së cilës do bëhet përmes punës sime profesionale, të pavarur, të paanshme dhe transparente.

Këto janë disa nga objektivat kryesore që do të përfshihen nën udhëheqjen time, por mund të ketë të tjera të veçanta në varësi të situatës së veçantë dhe prioriteteve të vendit.

3. Cilat janë vështirësítë që i prisni gjatë përbushjes së këtyre objektivave?

Disa prej vështirësive të mundshme gjatë punës janë:

Ndikimi në punën e Prokurorëve të cilët mund të përballen me ndikim qoftë edhe politik dhe presione të ndryshme kjo mund të kërcënojë pavarësinë dhe profesionalizmin e Prokurorisë;

Mungesa e burimeve mund të jetë një sfidë në punën e prokurorëve. Për një zbatim të ligjit me sukses, Prokurorët kanë nevojë për burime të mjaftueshme njerëzore, financiare dhe teknologjike.;

Ndërsa Prokurorët mund të kenë objektivin për të luftuar korrupzionin dhe veprat penale në përgjithësi, kjo paraqet sfidë të madhe sepse këto forma të kriminalitetit janë të përhapura dhe të fuqishme ;

Përmirësimi i kapaciteteve profesionale të prokurorëve dhe të stafit mbështetës është një objektiv i rëndësishëm, por mund të kërkojë kohë dhe përpjekje;

Përdorimi i teknologjisë informative mund të jetë sfidë për të sigruar sigurinë dhe integritetin e të dhënavë të ndjekura ;

Bashkëpunimi ndërkombëtar në rastet e krimeve që kanë ndikim ndërkombëtar, bashkëpunimi me autoritetet e tjera të drejtësisë në nivel ndërkombëtar mund të jetë sfidë duke marrë për bazë llojin e veprave penale të kryera, personave të përfshirë në ato vepra penale si dhe vendet prej nga vijnë duke llogaritur se jo gjithherë kemi raporte të mira bashkëpunimi me shtetet e ndryshme.

4.1 Si do t'i tejkalonit ato?

Tejkalimi i sfidave kërkon përkushtim të fortë, menaxhim të arsyeshëm të burimeve dhe një qasje të përshtatshme ndaj sfidave të veçanta të situatës.

Kryeprokurori dhe ekipi i tij duhet të jenë të përgatitur për të marrë masa të menjëherëshme dhe afatshkurtra në mënyrë që të menaxhojnë dhe të tejkalojnë sfidat aktuale.

III. Vizioni juaj për të avancuar administratën në Prokurorinë që keni aplikuar;

Ju lutem renditni hapat konkret që do t'i ndërmerrnit gjatë mandatit tuaj:

1. Cilat janë metodat dhe mënyrat tuaja për avancimin e stafit administrativ?
 2. Si planifikoni ndarjen e barabartë të punës për stafin administrativ?
 3. Si planifikoni të përmirësoni llogaridhëni dhe profesionalizmin e stafit administrativ?
-

Metodat dhe mënyrat për avancimin e stafit administrativ janë si në vijim:

Me qëllim të rritjes së efikasitetit të punës së stafit, trajnimi dhe zhvillimi për stafin administrativ do të jetë objektivë tjetër. Kjo mund të përfshijë seminare, kurse, dhe trajnime të specializuara për të rritur aftësitë e tyre;

Stafi administrativ duhet të ketë një mjedis të punës të motivueshëm, ku mund të ndihen të vlerësuar dhe të motivuar për të arritur rezultatet e detyrave të tyre;

Përmes mundësive ligjore do të bëhet përpjekje për të inkurajuar stafin që të angazhohen dhe të kërkojnë avancim në punë, e sidomos inkurajimi i stafit me nevoja të veçanta dhe stafit që vijnë nga radhët e komuniteteve jo shumicë ne Republikën e Kosovës.

Për të avancuar stafin administrativ me sukses, është e rëndësishme që organizimi i punës të jetë i përshtatshëm për të gjithë stafin me qëllim të kryerjes së punës në mënyrë sa më efektive.

Nga përvoja e deritashme si prokuror është treguar se ndarja e punës duhet të bëhet në mënyrë të drejtë, dhe se angazhimi i gjithë stafit të zyrës do të jetë i barabartë në ndarjen e detyrave të përditshme konform numrit të stafit dhe përshkrimit të detyrave të sipas rregullave ne fuqi.

Me që tani është në funksion regjistrimi elektronik i lëndëve sipas departamenteve, do të kemi kujdes të veçantë në ndarjen e lëndëve në mënyrë automatike përmes sistemit SMIL-ë.

Sa i përket llogaridhëniec nuk do të hezitojmë asnjë herë që të kërkojmë llogari nga stafi lidhur me detyrat e tyre të punës, çdo herë duke respektuar personalitetin individual të secilit si dhe duke respektuar Ligjin për te drejtat e punëtorëve.

IV. Hapat që do të ndërmerrni në përmirësimin e integritetit dhe llogaridhëniec në Prokurorinë që keni aplikuar dhe besimin e publikut?

Ju lutem listoni/përmendni veprimet e juaj afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjate:

1. Përvoja e juaj e deri tanishme?
 2. Hapat që do të ndërmerrni për të ngritur nivelin e besueshmërisë në Prokurorinë tuaj duke vënë baraspeshë mes transparencës dhe konfidentialitetit të procedurës?
 3. Çfarë planifikoni të ndërmerrni për të siguruar punë cilësore në Prokurorinë tuaj?
 4. Çfarë planifikoni të përmirësoni në llogaridhënen e përgjithshme në Prokurorinë tuaj?
-

1. Përvoja e juaj e deri tanishme?

Përvoja ime relativisht e gjatë, për mbi 14 vite si prokuror, vetëm ne sistemin Prokurorial, ndërsa rrëth 20 vite si jurist, më ka shtyrë të aplikoj në këtë pozite dhe vlerësoj se nga pozita e Kryeprokurorit mund të jap një kontribut të madh për të pasur një Prokurori bashkëkohore, efikase dhe profesionale.

Duke pasur parasysh edhe aftësitë analitike, njohjen e mirë të sistemit Prokurorial, meqë kam kaluar në të gjitha departamentet e tani së fundi edhe 5 vite si prokuror në PSRK, gjithashtu sukseset e mijë të deritanishme në ndjekjen, zbulimin dhe procedimit të rasteve nëpër Gjykata, konsideroj se paraqesin garanci të plotë dhe sukses për pozitën e Kryeprokurorit.

2. Hapat që do të ndërmerrni për të ngritur nivelin e besueshmërisë në Prokurorinë tuaj duke vënë baraspeshë mes transparencës dhe konfidentialitetit të procedurës?

Për të ngritur nivelin e besueshmërisë në Prokurorinë përkatëse dhe për të vendosur një baraspeshë të duhur mes transparencës dhe konfidentialitetit të procedurës, duhet që si udhëheqës i zyrës të i ndërmarrë disa nga hapat që janë të pashmangshëm për të siguruar transparencën dhe konfidentialitetin.

Do të bëhet rishikimi dhe zbatimi i politikave dhe procedurave ekzistuese, duke identifikuar çdo aspekt që mund të përmirësohet për të garantuar transparencën dhe konfidencialitetin, por pa ndikuar në profesionalizmin e procedurës.

Nëse ka nevojë do të hartohen politika të reja që përcaktojnë se si do të merren vendimet dhe se si do të menaxhohet informacioni i rëndësishëm, duke garantuar një përqendrim të qartë në respektimin e konfidencialitetit dhe në rritjen e transparencës;

Komunikimi me publikun dhe takimet e rregullta me publikun për të informuar ata rrëth veprimtarisë së Prokurorisë, përdorimi i mediave sociale dhe faqen zyrtare të Prokurorisë për të ndarë lajmet dhe informacionet e rëndësishme me publikun;

Publikimi i vendimeve të rëndësishme, kjo do të ndihmojë në garantimin e transparencës dhe besueshmërisë;

Bashkëpunimi me shoqërinë civile që monitorojnë veprimtarinë e Prokurorisë, do të ndihmojë në monitorimin e pavarësisë dhe transparencës së Prokurorisë;

Përmirësimi i teknologjisë informative, duke zhvilluar një platformë të teknologjisë informative për publikimin e të dhënavë të rëndësishme dhe të dokumenteve të Prokurorisë, duke u siguruar që ky informacion të jetë i sigurt dhe i qasshëm për publikun;

Përmirësimi i sigurisë së të dhënavës dhe ndërmarrja e masave për të siguruar sigurinë e të dhënavës të ndjekura dhe respektimi i konfidencialitetit të tyre.

3. Çfarë planifikoni të ndërmerrni për të siguruar punë cilësore në Prokurorinë tuaj?

Për të siguruar punë cilësore në Prokurorinë ku do të shërbej, do të ndërmarrë disa hapa të rëndësishëm që të siguroj se stafi i Prokurorisë të ketë mundësi për trajnim të vazhdueshëm dhe zhvillim të aftësive. Kjo përfshin seminare, kurse, dhe trajnime të specializuara për të përmirësuar kompetencat dhe aftësitë e tyre;

Planifikoj të kërkojë që KPK të kryej një proces të përzgjedhjes dhe rekrutimit të kujdesshëm të stafit për të siguruar se stafi i ri është i kualifikuar dhe ka aftësitë e nevojshme për të kryer detyrat në mënyrë cilësore;

Do të fokusohem në teknologjinë informative për të përmirësuar efikasitetin dhe cilësinë e veprimtarisë së Prokurorisë e cila do të përfshin sisteme të avancuara të mbledhjes së informacionit dhe të mbrojtjes së të dhënavës;

Planifikoj të ndërtoj një bashkëpunim të ngushtë me gjykatat, policinë, dhe organet e tjera të drejtësisë për të siguruar një koordinim të mirë në proceset e ndjekjes penale;

Siguroj që të drejtat dhe liritë e individëve të respektohen dhe mbrohen në çdo fazë të hetimit dhe ndjekjes penale;


4. Çfarë planifikoni të përmirësoni në llogaridhënien e përgjithshme në Prokurorinë tua?

Prokuroria duhet të jetë e hapur dhe të publikoj informacionin e saj rreth veprimtarisë, proceseve dhe vendimeve të saj. Ky informacion duhet të jetë i qasshëm për publikun, pa e cenuar pavarësinë institucionale duke e ruajtur pavarësinë e plotë nga ndikimet e jashtme. Kjo do të siguron që vendimet të janë të bazuara në ligj dhe standartet e përgjegjshmërisë.

Llogaridhënia në instanca më të larta siç janë Kryeprokurori i Shtetit dhe KPK, në mënyrë të rregullt, mbetet obligim i përcaktuar nga legjislacioni aktual dhe rregulloret në fuqi.

Koncept dokumenti nuk duhet të përmbajë më shumë se 10 faqe me shkrim e llojit Book Antiqua, madhësia 12, hapësirë njëshe.

Deklaroj se përbajtjen e këtij Koncept dokumenti e kam përgatitur vet, dhe jam në dijeni se Koncept dokumenti i Kryeprokurorit të emëruar do të publikohet në ueb faqe.

Nënshkrimi: 

Datë: 05.11.2024

FORMULARI NR.5

Formulari i vlerësimit të përgjithshëm të kandidatit

Emri dhe mbiemri i kandidatit: _____

ANËTARI	KONCEPT DOKUMENTI	INTEGRITETI	AFTESITE MENAXHERIALE DHE UDHEHEQESE	NJOHURITE TEKNOLOGJIKE DHE PERVOJA E NEVOJSHME PER POZITEN
A				
B				
C				
D				
E				